REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 50/23
Datë/Datum. 02.02.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Majlinda Bedrolli ***Ekspert shqyrtues*** MBedrolli	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***26.01.2023***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***02.02.2023***	***Nr. i lëndës:*** ***50/23***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23.01.2023, OE ankues **"Albi Company" shpk -Rahovec**, ka parashtruar ankesë me nr: **50/23,** kundër propozimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorve **"AAG PROJEKT; Enggroup SH.P.K."** lidhur me aktivitetin e prokurimit: ***"Ndërtim i sallës së edukatës fizike në shkollën fillore " 2 Korriku " në fshatin Loxhë në Pejë – Vazhdim i projektit RITENDER –II"*** me nr.të prokurimit**:635-22-14380-5-2-1,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KOMUNA E PEJES.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur–punë, vlerë e mesme, kriteri i dhënjes së kontratës tenderi i përgjegjshëm me Çmimi më te ulët.
Vlera e parashikuar 176,639.50 euro.

Data e njoftimit për kontratë: 15.12.2022
Dorzimi dhe hapja e ofertave 27.12.2022
DT 15.11.2022
B12 Procesverbali i hapjes se tenderve : 21.11.2022

Njoftimi mbi vendimin e AK: 06.12.2022

Pezullimi i aktivitetit te prokurimit 14.12.2022

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti teknik i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankus pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, siç janë:

Neni - 1
Neni – 6
Neni - 7
Neni - 59
Neni - 60
Neni – 69 të LPP-së

DEKLARATA DETALE E ANKESES
Vendimi mbi refuzimin e Kërkesën për rishqyrtim nga ana e AK-se KK Peje

AK KK Peje ne vendimin mbi refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim nuk ka te përshkruar asnjë kundër argumentuar për piket ankimore te paraqitura ne kërkesës për rishqyrtim me datën 11/01/2023,Ne Vendimin mbi refuzim te kërkesën për rishqyrtim AK-se thirret se OE fitues e plotëson kushtin kryesore te LPP çmimi me i lire.Si OE nuk pajtohemi me konstatimin e AK-se pasi qe sipas neni 60 LPP-se se pari OE fitues duhet te jete i përgjegjshëm dhe jo çmimi me i lire.

Te nderuar OSHP arsyeshmëria qe nuk pajtohemi me konstatimin e AK-se pasi qe AK-se nuk ka dëshmuar se ka marre ndonjë veprim-verifikim rreth verifikimit ne ATK rreth pikave ankimore te paraqitur ne ankesën për rishqyrtim,AK-se është obliguar duke bazuar me paragrafin 2 neni 99 te LPP-se qe ti verifikoje Referencat e lëshuar nga OE Enggroup për stafin profesional siç janë z. Besnik Krasniqi, Sabit Bytyqi, Halim Halimi dhe Xhelal Bislimi,

Sipas kushteve te kontratës se punës për stafit profesional te lartcekur nuk përputhet periudha e angazhimit sipas Referencave te lëshuar nga OE Eng Group.

Ak-se janë te obliguar e çdo pretendim ankimore te paraqiture ne kërkesën për rishqyrtim te ju përgjigjen. Ne ketë rast AK-se nuk ka respektuar LPP pasi qe nuk ka kërkuar informata shtese pranë ATK-se për stafin e

lartcekur se a janë paguar tatime sipas referencave te lëshuara.

Duke u bazuar se ne si OE ankues nuk kemi te drejte as mundësi ligjore qe te kërkojmë ndonjë verifikim për OE fitues pranë ATK-se

Atëherë :

Si OE ankues ju kërkojmë juve si OSHP qe te kërkoni verifikim pranë Administratës Tatimore te Kosovës ATK-se periudhën e angazhimit sipas Referencave tek OE Eng Group te stafit profesional te z. Besnik Krasniqi - pika ankimore nr 1, z.Sabit Bytyqi- pika ankimore nr 2, Halim Halimi -pika ankimore nr 4 dhe Xhelal Bislimi - pika ankimore nr 6 te cilët nuk përputhen sipas kushteve te kontratës se nënshkruar.

Presim qe nga ana juaj qe verifikohet këto dyshime te cilat si OE pretendojmë- dyshojmë se periudha e angazhimit sipas referencave mund te jene me informata te rrejshme.

Gjithashtu si OE ankues kemi paraqitur se grupi OE fitues janë te pa përgjegjshëm siç janë te përshkruar ne piken ankimore nr 3 si OE bazuar me dokumentat kemi konstatuar se z. Bytyqi nuk e mbulon përvojën me Referenca pas diplomimit dhe ne piken ankimore nr 4 kemi konstatuar se diploma e z, Halimi ka dorëzuar diplomën e noterizuar pa ngjyra-

Presim konstatime ne pajtueshmëri me LPP për pikat ankimore ne kërkesën për rishqyrtim.

Ne si OE ankues pretendojmë - dyshojmë se konserciumi fitues është i pa përgjegjshëm dhe ne dosje tenderit pretendojmë - dyshojmë se ka dokumente me informata te rrejshme te cilat bazuar me paragrafin 2 te nenit 99 te LPP ju kërkojmë qe te verifikohen pranë Administratës Tatimore te Kosovës dhe nëse verifikohet atëherë kërkojmë qe ndermirën masa ligjore.Nëse ju si ZP nuk ndërmerrni ndonjë veprim qe te verifikohen pretendimet tona te paraqitura ne pikat ankimore atëherë si OE ankues pa vullnetin tone si OE do të jemi te obliguar qe ta paraqesim Ankese ne OSHP gjithashtu do te ti paraqesim për verifikim pranë Institucioneve tjera Ligjore.

PIKA ANKIMORE NR 1

Konserciumi ka caktuar projekt menaxher z Besnik Krasniqi me profesione inxhinier I Arkitekturës

• Sipas dokumenteve te dorëzuar ne dosje tenderit janë dorëzuar disa Referenca te cilët nuk konfirmohet se ka qene ndonjë here menaxher I projektit, Andaj z Krasniqi nuk ka përvoje pune si menaxher I projektit.

Bazuar me nenin 4 te kontratës z. Krasniqi ka themeluar marrëdhënie pune nga data 04.01.2020 me kompaninë ENG group po ashtu bazuar me nenin 5 te kontratës z.Krasniqi I punësuari është I detyruar te filloje punës me datën 04.01.2020 dhe bazuar me nenin 23 te kontratës kontrata është nënshkruar ndërmjet palëve me datën 04.01.2020.

Periudha e angazhimit te z. Krasniqi sipas kontratës përshkruhet qe është I angazhuar me datën 04.01.2020 ndërsa Referencat e lëshuar nga OE Eng group Shtator/2020 përshkruhet se ka qene I angazhuar nga viti 2010.

Kërkese: Duke u bazuar ne mos përputhjen e te dhënave te përshkruara ne kontrate dhe ne Referenca atëherë si OE ankues pretendojmë - dyshojmë se periudha e angazhuar sipas Referencave te lëshuara nga OE Enggroup për z. Krasniqin është e dyshimte-fiktive dhe KERKOJME qe te verifikohet pranë Administratës Tatimore te Kosovës periudha e angazhimit te z, Kraniqi tek kompania Enggroup.

Bazuar me ligjet ne Kosove përvoja e punës duhet konsideruar vetëm pasi qe te jene paguar Tatimi ne te Ardhura.

PIKA ANKIMORE NR 2

5.3) Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik- minimum 6 vite përvoja pune pas diplomimit

•Konserciumit I OE ka angazhuar për Inxhinier te Ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknik z.Sabit Bytyqi I diplomuar me datën 07/10/2004

•Për z. Bytyqi janë bashkëngjitur këto Dokumente:

Sipas CV-se përshkruhet se z. Bytyqi është I angazhuar tek OE Eng group nga viti 2018 por ne dokumente ju është bashkëngjitur Referenca e datës 21/12/2020 ju kanë përshkruar edhe vitet 2016 qe dmth ka mos përputhje.

Bazuar me nenin 4 te kontratës z. Sabit Bytyqi ka themeluar marrëdhënie pune nga data 06.01.2020 me kompaninë ENG group po ashtu bazuar me nenin 5 te kontratës z.Bytyqi I punësuari është I detyruar te filloje punës me datën 06.01.2020 dhe bazuar me nenin 23 te kontratës kontrata është nënshkruar ndërmjet palëve me datën 06.01.2020.

Kërkese: Duke u bazuar ne mos përputhjen e te dhënave te përshkruara ne kontrate dhe ne Referenca atëherë

si OE ankues pretendojmë - dyshojmë se periudha e angazhuar sipas Referencave te lëshuar nga OE Enggroup për z. Bytyqi është e dyshimte-fiktive dhe KERKQJME qe te verifikohet pranë Administratës Tatimore te Kosovës periudha e angazhimit te z, Sabit Bytyqi tek kompania Enggroup

PIKA ANKIMORE NR 3

Për z Bytyqi janë dorëzuar këto Referenca për ta mbuluar përvojën e punës 6 vite pas diplomimit:

- Referenca e datës 16/12/2002 nga NGO Alisei ka përshkruar periudhën e angazhimit prej 03/08/1999 deri 16/12/2022 - Kjo periudhe e angazhimit tek ALISEI është e pa pranuar pasi qe nuk ka pasur diplome z. Bytyqi , ku është I diplomuar me datën 07/10/2004.

- Referenca e datës 30/06/2003 nga MORINA e cila ka përshkruar periudhën 03/09/2022 deri 30/06/2033 Kjo periudhe e angazhimit tek Morina është e pa pranuar pasi qe nuk ka pasur diplome z. Bytyqi, ku është I diplomuar me datën 07/10/2004.

- Referenca nga KAG Asplalt e cila ka përshkruar periudhën 23/06/2003 deri 03/12/2004 Kjo periudhe e angazhimit tek KAG është e pranueshme vetëm 2 muaj pasi qe nuk ka pasur diplome z. Bytyqi , ku është I diplomuar me datën 07/10/2004. Referenca e KAG është pa ngjyra

- Referenca e datës 2008 nga Getoari e cila ka përshkruar periudhën 2002 deri ne fillim te vitit 2007. Periudha 2002, 2003 dhe 2004 janë te pa pranueshme pasi qe nuk ka disponuar z, Bytyqi diplomën. Ndërsa e pranueshme është përvoja e punës për vitin 2005 dhe 2006 qe dmth përvoja e z, Bytyqi tek Getoari sipas Referencës 2008 është e pranueshme vetëm 2 vite sepse z. Bytyqi , ku është I diplomuar me datën 07/10/2004. Referenca e Getoari është pa ngjyra.

- Referenca e lëshuar nga D-Projekt nuk ka te përshkruar periudhën e angazhimit

- Referencat te Shtator 2020 tjera te lëshuar nga OE Eng Group për z, Bytyqi ku sqaron se është I angazhuar nga Viti 2018 si OE konsiderojmë qe periudha e angazhimit te z, Bytyqi është dyshuese dhe sipas referencës është I angazhuar nga viti 2018 dhe referenca Shtator 2020 janë 2 vite e 9 muaj.

Andaj si OE ankues pretendojmë se z. Sabit Bytyqi nuk ka ofruar dëshmi 6 vite përvoje pune pas diplomimit me Referenca nga Punëdhënësi pasi qe te Referencat e dorëzuar nuk mbulojnë periudhën 6 vite te kërkuar pas

diplomimit.

PIKA ANKIMORE NR 4.

5.5) Një (1) inxhinier i diplomuar i Makinerisë - minimum 6 vite përvojë pune pas diplomimit;

Konserciumi kanë dorëzuar dokumente për Inxhinierin e makinerisë z.Halim Halimi.

Bazuar me dokumentet e dorëzuar ne dosje tenderit për z, Halim Halimi është dorëzuar diploma Kopje e noterizuar pa ngjyra.

Sipas CV dhe referencave përshkruhet se z.Halim Halimi është I angazhuar ne kompaninë Eng group nga viti 2010 dhe vazhdon. Por bazuar me nenin 4 te kontratës z. Halim Halimi ka themeluar marrëdhënie pune nga data 06.01.2020 me kompaninë ENG group po ashtu bazuar me nenin 5 te kontratës z.Halimi I punësuari është I detyruar te filloje punën me datën 06.01.2020 dhe bazuar me nenin 23 te kontratës kontrata është nënshkruar ndërmjet palëve me datën 06.01.2020.

KERKESE: Duke u bazuar ne mos përputhjen e te dhënave te përshkruara ne kontrate dhe ne Referenca atëherë si OE ankues pretendojmë -dyshojmë se periudha e angazhuar sipas Referencave te lëshuar nga OE Enggroup për z. Halimi është e dyshimte-fiktive dhe KERKOJME qe te verifikohet pranë Administratës Tatimore te Kosovës periudha e angazhimit te z, Halim Halimi tek kompania Enggroup

Po ashtu Konserciumi për inxhinier Makinerisë ka dorëzuar dokumentet e z Besim Ibrahimi ku sipas dokumenteve ne dosje tenderit është Referenca e lëshuar nga CHF e datës May 28/2012 ku është përshkruar periudha e angazhimit te z Ibrahimi nga Shkurti 2011 deri Maj/2012

Për z. Halimi i nuk është dëshmuar përvoja e punës min 6 vite me Referenca nga punëdhesi.

PIKA ANKIMORE NR 5.

5.4) Një (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikes - minimum 6 vite përvoja pune pas diplomimit;

Konserciumi kanë dorëzuar dokumente për Inxhinierin Elektros z.Xhelal Bislimi.

• Sipas CV dhe referencave përshkruhet se z, Xhelal Bislimi është I angazhuar ne kompaninë Eng group nga viti 2006 dhe vazhdon. Por bazuar me nenin 4 te kontratës z. Halim Halimi ka themeluar marrëdhënie pune nga

data 06.01.2020 me kompaninë ENG group po ashtu bazuar me nenin 5 te kontratës z,Bislimi i I punësuari është I detyruar te filloje punës me datën 06.01.2020 dhe bazuar me nenin 23 te kontratës kontrata është nënshkruara ndërmjet palëve me datën 06.01.2020.

KERKESE: Duke u bazuar ne mos përputhjen e te dhënave te përshkruara ne kontrate dhe ne Referenca atëherë si OE ankues pretendojmë dyshojmë se periudha e angazhuar sipas Referencave te lëshuar nga OE Enggroup per z. Bislimi është e dyshimte-fiktive dhe KERKOJME qe te verifikohet pranë Administratës Tatimore te Kosovës periudha e angazhimit te z, Bislim tek kompania Enggroup

SHKELJET LIGJORE :

Prova paragrafi 1 neni 1 LPP: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Prova paragrafi 1 neni 6 Lpp -se : Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Prova paragrafi 1, 2 dhe 6 neni 7 Lpp-se

1.Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Neni 59, i LPP-së, ju si AK KK Peje nuk keni vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar procedurën tenderuese te vlerësimit ne pajtim me LPP pasi qe keni shpërblyer me kontrate OE fitues i cili nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuar ne dosjen e tenderit

Neni 60, i LPP-së , ju si AK duke mos respektuar nenin 60 te LPP-se ku përcaktohet ne piken 1.1 te neni 60 se duhet te shpërblehet OE konkurrues i cili i cili është i përgjegjshëm me çmim me te lire, e ne ketë rast ju si AK

keni shpërblye me kontrate OE fitues i cili nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuar ne FTD,

Neni 69 LPP-se , OE fitues janë te pa përgjegjshëm pasi qe nuk i kanë plotësuar kërkesat e stafit profesional dhe teknik rreth stafit te kërkuar dhe pajisjeve te nevojshme te kërkuar sipas kritereve ne FTD dosje tenderit.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të merrni:

Të nderuar/a kërkojmë nga ju që të zbatoni procedurat dhe dispozitat e LPP-së, sepse jeni të thirrur ta bëni këtë gjë dhe mos vazhdoni të na diskriminoni dhe të na dëmtoni, për shkak se ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe natyrisht duhet të jemi fitues të kësaj kontrate dhe për të ardhur deri këtu kemi bërë një punë, angazhim dhe mund të madh, dhe kemi bërë shpenzime materiale.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të merrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "Albi Company"

ANULOHET, njoftimi për vendimi i AK-se të aktivitetit të prokurimit dhe lënda te kthehet ne rivlerësim , dhe te shpërblehemi si OE pasi qe jemi te përgjegjshëm me çmim me te lire.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Kërkesa 4** **Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me dokumentacion mbi sigurine dhe shendetine ne pune sipas ligjit 04-L-161.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Dëshmia 4** **OE duhet te jete i pajisur me Certifikate-kopje te noterizuar, Dokumentin per vlersimin e rriskut, si dhe licencen e noterizuar te kompanise e cila e ka kryer licencimin.**
		Kerkese 5 **5.1) Menaxher i projektit, duhet te jete inxhinier i diplomuar i arkitektures – minimum 7 vite pervoje pune pas diplomimit;** **5.2) Udheheqes i punimeve, duhet te jete inxhinier i diplomuar i ndertimtarise-**	**Deshmia 5** - *Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Si dhe per piken 5.1. Vendimi per menaxher te projektit dhe piken 5.2.Vendimi per udheheqes te punimeve**

		drejtimi konstruktiv - minimum 7 vite pervoj pune pas diplomimit; 5.3) Nje (1) inxhinier i diplomuar i ndertimtarise - drejtimi hidroteknik- minimum 6 vite pervoj pune pas diplomimit; 5.4) Nje (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikes - minimum 6 vite pervoj pune pas diplomimit; 5.5) Nje (1) inxhinier i diplomuar i Makinerise - minimum 6 vite pervoj pune pas diplomimit;	

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 06.01.2023, është konstatuar si në vijim: AK-Komuna e Pejës, shpërblen me kontratë Grup e Operatorëve Ekonomik AAG PROJEKT; Enggroup SH.P.K., ne vlere totale te ofertës: 175,617.20 euro.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Autoriteti kontraktues Komuna e Pejës ka zbatuar procedurë të hapur–punë, vlerë e mesme, kriteri i dhënjes së kontratës tenderi i përgjegjshëm me Çmimi më te ulët.

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) "Albi Company" shpk -Rahovec

Në lidhje me pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me çështjen e përvojës së punës dhe verifikimit të përvojës në ATK për të gjithë inxhinierët, ekspertja shqyrtuese fillimisht sqaron kërkesën e dosjes së tenderit, ku komisioni i vlerësimit dhe shyqrtimi i kësaj ankese bëhet në bazë të kërkesave të cilat janë vendosur në dosje të tenderit. AK në dosje të tenderit ka kërkuar:

Kerkese 5	**Deshmia 5 -Diplomat - kopje te noterizuara, -Kontrata e**

5.1) Menaxher i projektit, duhet te jete inxhinier i diplomuar i arkitektures – minimum 7 vite pervoje pune pas diplomimit; **5.2) Udheheqes i punimeve, duhet te jete inxhinier i diplomuar i ndertimtarise-drejtimi konstruktiv - minimum 7 vite pervoj pune pas diplomimit;** **5.3) Nje (1) inxhinier i diplomuar i ndertimtarise - drejtimi hidroteknik- minimum 6 vite pervoj pune pas diplomimit;** **5.4) Nje (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikes - minimum 6 vite pervoj pune pas diplomimit;** **5.5) Nje (1) inxhinier i diplomuar i Makinerise - minimum 6 vite pervoj pune pas diplomimit;**	**punes kopje nese inxhinjeri eshte ne liste te pagave ne 6 muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate, (në rast të angazhimit për këtë projekt, kontrata e menaxherit me ofertuesin duhet të jetë e noterizuar dhe e nënshkruar nga të dy palet në prezencë të noterit). -Leter reference nga punedhenesit ose cfaredo dokumenti tjeter qe deshmon per punet dhe pervojen e meparshme inxhinierike ne lemine e caktuar. Si dhe per piken 5.1. Vendimi per menaxher te projektit dhe piken 5.2.Vendimi per udheheqes te punimeve**

Në bazë të kërkesave të cekura si më lartë, ekspertja shqyrtuese sqaron se AK për secilin inxhinier ka kërkuar përvojën e punës, ndërsa si dëshmi të kërkuar dokumentare ka kërkuar kontratën e punës, nëse inxhinieri është me kontratë të jetë në listën e pagave në 6 muajt e fundit, dhe si dëshmi ka kërkuar letër referencë ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për përvojën e më parshme. Pra, sipas kësaj që u tha, ekspertja shqyrtuese sqaron se AK në dosje të tenderit nuk ka kërkuar që secila përvoja e punës apo referëncë e inxhinierëve të dëshmohet me listën e pagave. Andaj, përgjigjet në pretendimet ankimore do të jepen duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit, ashtu siç është prezantuar kërkesa më lartë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Albi Company" shpk -Rahovec se OE i rekomanduar për kontratë "AAG PROJEKT; Enggroup SH.P.K." ka caktuar projekt menaxher z Besnik Krasniqi me profesione inxhinier i Arkitekturës ku sipas dokumenteve te dorëzuar ne dosje tenderit ka dorëzuar disa referenca të cilët nuk konfirmohet se ka qene ndonjë here menaxher i projektit, Andaj z Krasniqi nuk ka përvoje pune si menaxher I projektit.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se inxhinieri Besnik Krasniqi sipas dokumenteve të dorëzuara me tender, se në vitin 2009 dhe 2010 ishte menaxher i projekteve në kompaninë N&B Projekt, nga viti 2013 deri në vitin 2016 ishte mbikëqyrës i projektit në kompaninë "Euro Besi" Sh.p.k., si dhe sipas referencës e cila gjendet në tender rrjedh se nga vitit 2010 deri në vitin 2020 ishte në kompaninë ENG GROUP. Pra, lidhur me këtë përvojë, i njëjti ka bashkangjitur diplomën e kualifikimit sipas kërkesës së FDT-së, referencat sipas kërkesës, kontratën e punës me tani OE të rekomanduar për kontratë, si dhe i njëjti është në listën e pagave në 6 muajt e fundit ashtu siç është kërkesa e dosjes së tenderit. Andaj pretendimi ankimor është i pa qëndrueshëm

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Albi Company" shpk -Rahovec se OE i rekomanduar për kontratë "AAG PROJEKT; Enggroup SH.P.K." ka angazhuar për Inxhinier te Ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknik, z.Sabit Bytyqi I diplomuar me datën 07/10/2004 dhe i njejti nuk ka ofruar dëshmi 6 vite përvoje pune pas diplomimit me Referenca nga Punëdhënësi pasi që te Referencat e dorëzuar nuk mbulojnë periudhën 6 vite të kërkuar pas diplomimit. **Ekspertja shqyrtuese** sqaron se për këtë inxhinier, OE i rekomanduar me tender ka bashkangjitur diplomën e kualifikimit të datës 07.10.2004, referencën e lëshuar nga kompania "Getoari" për vitin 2005 dhe 2006, referencën e lëshuar nga kompania "Getoari" për vitin 2010, referencën e lëshuar nga kompania "Eng Group" për vitet 2018 deri 2020, kontratën e punës me kompaninë "Eng Group" të datës 06.01.2020, si dhe është në listën e pagave në 6 muaj e fundit të kompania "Eng Group". Pretendimi ankimor është i pa qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Albi Company" shpk -Rahovec se OE i rekomanduar për kontratë "AAG PROJEKT; Enggroup SH.P.K." per Inxhinierin e makinerisë ka prezantuar z.Halim Halimi i njeti nuk ka dëshmuar provojen e punes min 6 vite me referenca dhe njeherit ka dorëzuar diploma kopje e noterizuar pa ngjyra. **Ekspertja shqyrtues** sqaron se për inxhinierin Halim Halimit, OE i rekomanduar me tender ka prezantuar diplomën e kualifikimit arsimor sipas kërkesës së FDT-së të lëshuar me datë 31.01.2008, referencën e lëshuar nga kompania "Alping" për periudhën 01.02.2009 deri me 01.02.2010, referencën e lëshuar nga "ENG Group" për vitet 2010 – 2020, kontratën e punës të datës 06.01.2020 të lëshuar nga "ENG Group", si dhe është në listën e pagave në 6 muajt e fundit. Sa i përket pikës ankimore se kopjen e diplomës së noterizuar e ka pa ngjyra, ekspertja shqyrtuese sqaron se në dosje të tenderit nuk ka qenë e saktësuar nëse kopja e diplomës duhet

të jetë me ngjyra apo pa ngjyra, por kërkesë e dosjes ka qenë që diploma të jetë e noterizuar ndërsa për këtë inxhinier diploma është e noterizuar. Andaj, pretendimit ankimor është i pa qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Albi Company" shpk -Rahovec se OE i rekomanduar për kontratë "AAG PROJEKT; Enggroup SH.P.K." per Inxhinierin të elektronikes ka prezantuar z.Xhelal Bislimi ku dyshojm se per të njeti periudha e angazhuar sipas Referencave te lëshuar nga OE Enggroup per z. Bislimi është e dyshimte-fiktive dhe KERKOJME qe te verifikohet pranë Administratës Tatimore te Kosovës periudha e angazhimit te z, Bislim tek kompania Enggroup. **Ekspertja shqyrtuese** ashtu siç e ka cekur në fillim të shqyrtimit të kësaj ankesë në lidhje me çështjen e deklarimit të punëtorëve në ATK, edhe tani e ri përsërit se kërkesë e dosjes së tenderit nuk ka qenë që për secilën referencë dhe kontratë të jenë të deklaruar në ATK. I vetmi kufizim sipas kërkesës së dosjes së tenderit ka qenë që punëtorët të cilët posedojnë kontratë të jenë të deklaruar në ATK në 6 muajt e fundit. Kurse sa i përket inxhinierit Xhelal Bislimi, ekspertja sqaron se është në listën e pagave në 6 muajt e fundit sipas dokumentit të dorëzuar me tender, posedon kualifikimin arsimor sipas kërkesës së FDT-së e lëshuar me datë 30.09.1999, si dhe në bazë të referencës së lëshuar nga "ENG Group" është i punësuar nga viti 2006 deri në vitin 2020. Andaj, pretendimit ankimor është i pa qëndrueshëm.

8. MENDIMI I EKSPERTIT TEKNIK

Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues qe ankesa e OE ankues "Albi Company" shpk -Rahovec, të refuzohet si e pa bazuar, dhe ti lejohet AK-së që të procedoj tutje me këtë procedurë të prokurimit.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues – Komuna Pejë

Panelit Shqyrtues - OSHP.

OE ankues - "Albi Company" shpk -Rahovec